

Vendim nr. 157 datë 04.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 04.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (F) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: FAIK DRIZA, BAJAME DRIZA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 53, datë 22.01.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë; nr. 2839, datë 22.06.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-484, datë 20.02.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit Faik Driza, pas kërkesës së tij, mbështetur në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 7703/1993*), Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier (*DRSSH, Fier*) i ka lidhur pension pleqërie për një periudhë sigurimi prej 31 vjetësh, për periudhën 1960 - 1994, në Ndërmarrjen Bujqësore “Çlirimi”, Fier (*NB “Çlirimi”, Fier*), me të drejtë pagese nga data 14.10.1995 e në vazhdim. Po ashtu, pas kërkesës së tij, edhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë (*DRSSH, Tiranë*), i ka lidhur kërkuesit Faik Driza pension pleqërie për një periudhë sigurimi prej 30 vjetësh e 5 muajsh, konkretisht 1961 - 1991, në Ndërmarrjen Bujqësore “Gjergj Dimitrov”, Tiranë (*NB “Gjergj Dimitrov”, Tiranë*), me të drejtë pagese nga data 01.02.1998 e në vazhdim.

2. Nga auditi i brendshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*ISSH*) është konstatuar se kërkuesi Faik Driza ka përfituar në të njëjtën kohë dy pensione pleqërie dhe se periudha e sigurimit 1961 - 1991 është e dubluar, ndërsa kërkuesit i është njohur si e tillë qoftë vjetërsia në punë në NB-në “Çlirimi”, Fier ashtu edhe në NB-në “Gjergj Dimitrov”, Tiranë. Në vijim, me urdhrin nr. 9881, datë 23.12.2013 (*urdhri nr. 9881/2013*), *ISSH*-ja ka urdhëruar: (i) mbylljen e përfitimit nga kërkuesi të pensionit të pleqërisë pranë *DRSSH*-së, Fier, deklarinimin e tij debitor për të gjithë shumën e përfituar padrejtësisht dhe paraqitjen e kallëzimit penal ndaj tij për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve të vjetërsisë në punë, përdorimit të dokumenteve të falsifikuara dhe mashtrimit; (ii) ndalimin e shumës debitore të përfituar padrejtësisht kërkuesit, duke zbatuar ndalesën në masën 50% të këstit mujor. Kërkuesi ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit për përgjysmimin e pensionit, në përgjigje të së cilës, me shkresën nr. 8161/1, datë 17.12.2014, *ISSH*-ja i ka bërë të ditur se ai është debitor për shumën 1 965 952 lekë.

3. Për sa i përket kërkueses Bajame Driza, pas kërkesës së saj, *DRSSH*-ja, Fier i ka lidhur pension pleqërie për një periudhë sigurimi prej 29 vjetësh e 1 muaji, konkretisht 1966 - 1995, në Ndërmarrjen e Bonifikimit, Ndërmarrjen Tregtare të Shitblerjes dhe Ndërmarrjen Komunale Banesa, Fier, me të drejtë pagese nga data 02.01.1997 e në vazhdim. Po ashtu, pas kërkesës së saj, edhe *DRSSH*-ja, Tiranë i ka lidhur kërkueses Bajame Driza pension pleqërie për një periudhë sigurimi prej 29 vjetësh e 6 muajsh, konkretisht 1962 - 1991, në NB-në “Gjergj Dimitrov”, Tiranë, me të drejtë pagese nga data 02.07.2000 e në vazhdim.

4. Nga auditi i brendshëm i *ISSH*-së është konstatuar se kërkuesja Bajame Driza ka përfituar në të njëjtën kohë dy pensione pleqërie dhe se periudha e sigurimit 1966 - 1991 është e dubluar, ndërsa kërkueses i është njohur si e tillë qoftë vjetërsia në punë në Ndërmarrjen e

Bonifikimit, Ndërmarrjen Tregtare të Shitblerjes dhe Ndërmarrjen Komunale Banesa, Fier, ashtu edhe në NB-në “Gjergj Dimitrov”, Tiranë. Në vijim, me urdhrin nr. 8713/2, datë 18.11.2013 (urdhri nr. 8713/2/2013), ISSH-ja ka urdhëruar: (i) mbylljen e përfitimit nga kërkuesja të pensionit të pleqërisë pranë DRSSH-së, Tiranë, deklarimin e saj debitore për të gjithë shumën e përfituar padrejtësisht dhe paraqitjen e kallëzimit penal ndaj saj për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve të vjetërsisë në punë, përdorimit të dokumenteve të falsifikuara dhe mashtrimit; (ii) ndalimin e shumës debitore të përfituar padrejtësisht kërkueses, duke zbatuar ndalesën në masën 50% të këstit mujor. Kërkuesja ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit për përgjysmimin e pensionit, në përgjigje të së cilës, me shkresën nr. 959/7, datë 17.12.2014, ISSH-ja i ka bërë të ditur se ajo është debitore për shumën 1 501 462 lekë.

5. Në datën 12.01.2015 kërkuesit kanë paraqitur padi, duke kërkuar pavlefshmërinë e urdhrave të ISSH-së për shqyrtimin e dosjeve të tyre të përfitimit të pensionit të pleqërisë. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 366, datë 20.03.2015, ka vendosur pranimin e padisë së kërkuesve, duke: (i) konstatuar pavlefshmërinë e urdhrit nr. 9881/2013 të ISSH-së për shqyrtimin e dosjeve të përfitimit në emër të paditësit (kërkuesit) Faik Driza dhe urdhëruar trajtimin e tij me pension pleqërie pranë DRSSH-së, Fier dhe mbylljen e pensionit të pleqërisë pranë DRSSH-së, Tiranë, si dhe përlllogaritjen e ndalesës për përfitimin e padrejtë për tre vjetët e fundit, në masën 20% të këstit mujor; (ii) konstatuar pavlefshmërinë e urdhrit nr. 8713/2/2013 për shqyrtimin e dosjeve të përfitimit në emër të paditëses (kërkueses) Bajame Driza dhe urdhëruar përlllogaritjen e ndalesës për përfitimin e padrejtë vetëm për tre vjetët e fundit, në masën 20% të këstit mujor. Mbi ankimin e të paditurve, DRSSH-së, Tiranë dhe DRSSH-së, Fier, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2125, datë 12.10.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë.

6. Në rigjykimin e çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 53, datë 22.01.2016, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesve. Ky vendim, me ankimin e kërkuesve, është ndryshuar nga Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2839, datë 22.06.2017, me të cilin ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë së kërkuesve, duke urdhëruar: (i) shfuqizimin e urdhrit nr. 9881/2013 të ISSH-së për paditësin (kërkuesin) Faik Driza dhe detyrimin e palës të paditur për të bërë përlllogaritjet dhe për ta shpallur atë debitor vetëm për pensionin e pleqërisë së përfituar në mënyrë të kundërligjshme nga DRSSH-ja, Tiranë; (ii) rrëzimin e padisë për pjesën tjetër. Në vijim, për rekursin e kërkuesve, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-484, datë

20.02.2024, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

7. Kërkesit në datën 11.04.2024 (*data e shërbimit postar*) i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili është regjistruar në datën 25.04.2024, pas plotësimit sipas kërkesave të ligjit.

II

Pretendimet e kërkuësve

8. **Kërkesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar:

- 8.1. *Cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor*, pasi gjykata administrative e shkallës së parë ka marrë përsipër të interpretojë nenin 62 të ligjit nr. 7703/1993, në një kohë kur detyra e saj është të analizojë faktet dhe rrethanat e çështjes për të dhënë një vendim të drejtë. Edhe Gjykata Administrative e Apelit nuk ka analizuar dhe argumentuar mbi baza ligjore ankimin e kërkuësve, në lidhje me interpretimin e nenit 62, pika 3, paragrafi i parë, të ligjit nr. 7703/1993, në të cilin parashikohet se e drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti, ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës për çdo muaj është 20 % e këstit mujor. Për më tepër, ajo gjykatë nuk është shprehur në dispozitivin e vendimit për padinë e kërkuësves Bajame Driza. Pavarësisht shkeljeve të ligjit nga gjykatat më të ulëta, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësve, duke lënë në fuqi në këtë mënyrë vendimin e gjykatës së apelit.
- 8.2. *Cenimin e së drejtës së pensionit të pleqërisë*, pasi gjykatat e të tria shkallëve kanë interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuësve*

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person

fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, Kolegji vlerëson se kërkuessit, si individë, legjitimohen *ratione personae* në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse janë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

11. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës pas përfundimit të gjykimit në të tria shkallët e gjykimit, për rrjedhojë përmbushet kriteri i shterimit të mjeteve juridike.

12. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Kolegji konstaton se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar nga kërkuessi mban datën 20.02.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 11.04.2024, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga ligji.

13. Në drejtim të legjitimitit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuessit kanë pretenduar se gjatë gjykimit të çështjes është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 62, pika 3, të ligjit nr. 7703/1993. Për më tepër, Gjykata Administrative e Apelit nuk është shprehur në dispozitivin e vendimit për padinë e kërkuesses Bajame Driza. Pavarësisht shkeljeve të ligjit nga gjykatat më të ulëta, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuessesve, duke lënë në fuqi në këtë mënyrë vendimin e gjykatës së apelit. Gjithashtu, sipas kërkuessesve, është cenuar edhe e drejta e pensionit të pleqërisë, pasi gjykatat e të tria shkallëve kanë interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin.

14. Kolegji, duke mbajtur në konsideratë se argumentet për cenimin e së drejtës për pension lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkuesve, çmon të trajtojë pretendimet e paraqitura në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës. Gjithashtu, nisur nga thelbi i argumenteve të parashtruara nga kërkuesit, në mbështetje të pretendimeve të tyre, Kolegji konstaton se ato kanë të bëjnë me të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, të cilat hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do t'i analizojë në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

15. Kërkuesit kanë pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin nr. 7703/1993. Për më tepër, Gjykata Administrative e Apelit nuk është shprehur në dispozitivin e vendimit për padinë e kërkueses Bajame Driza. Pavarësisht shkeljeve të ligjit nga gjykatat më të ulëta, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve. Si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit është cenuar edhe e drejta e pensionit të pleqërisë.

16. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata ka theksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e saj është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve

gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor ka nisur pas padisë së kërkuesve që kanë kërkuar pavlefshmërinë e urdhrave të ISSH-së për shqyrtimin e dosjeve të tyre të përfitimit të pensionit të pleqërisë. Në përfundim të gjykimit, gjykata administrative e shkallës së parë ka vendosur pranimin e padisë së kërkuesve. Ky vendim është prishur nga Gjykata Administrative e Apelit dhe çështja është dërguar për rigjykim në atë gjykatë.

20. Në rigjykimin e çështjes, gjykata administrative e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesve, me arsyetimin se ata kanë përfituar të ardhura nga sigurimet shoqërore me mënyra dhe mjete në kundërshtim me ligjin, ndërsa kanë përfituar pension të dyfishtë pleqërie, në një kohë kur sipas ligjit nr. 7703/1993, çdo person ka të drejtën e përfitimit vetëm të një pensioni pleqërie, ndërkohë që e drejta e organeve të sigurimeve shoqërore për të kërkuar kthimin e shumës së përfituar padrejtësisht nuk parashkruhet.

21. Pas ankimit të kërkuesve, Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, duke pranuar pjesërisht padinë e kërkuesve dhe urdhëruar: (i) shfuqizimin e urdhrit nr. 9881/2013 të ISSH-së për paditësin (kërkuesin) Faik Driza dhe detyrimin e palës të paditur për të bërë përlllogaritjet dhe për ta shpallur atë debitor vetëm për pensionin e pleqërisë së përfituar në mënyrë të kundërligjshme nga DRSSH-ja Tiranë; (ii) rrëzimin e padisë për pjesën tjetër. Gjykata e apelit ka arsyetuar se ISSH-ja ka vepruar gabim kur ka urdhëruar mbylljen e pensionit të pleqërisë që kërkuesi Faik Driza përfitonte nga DRSSH-ja, Fier, në një kohë kur pensioni i pleqërisë që ai ka përfituar padrejtësisht është ai nga DRSSH-ja, Tiranë, pasi kërkuesi ka qenë me banim në Fier dhe nuk ka punuar asnjëherë në Tiranë, duke mos pasur vjetërsi punë në NB-në “Gjergj Dimitrov”. Për rrjedhojë, sipas gjykatës së apelit, pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin në urdhrin e nxjerrë ndaj kërkuesit Faik Driza. Lidhur me kërkuesen Bajame Driza, gjykata e apelit ka vlerësuar se urdhri i nxjerrë ndaj saj është në përputhje me ligjin, ndërsa me të drejtë është urdhëruar mbyllja e pensionit të pleqërisë që ajo përfitonte padrejtësisht nga DRSSH-ja, Tiranë.

22. Po ashtu, Gjykata Administrative e Apelit ka gjetur të pabazuar në ligj pretendimin e paditësve (kërkuesve) të ngritur sipas paragrafit të parë të pikës 3 të nenit 62 të ligjit nr. 7703/1993 për parashkrimin e së drejtës së organeve të sigurimeve shoqërore për të kërkuar kthimin e përfitimit të padrejtë përtej periudhës 3-vjeçare dhe për sa i përket masën mujore të

ndalesës për kthimin e këtij përfitimi. Ajo gjykatë ka arsyetuar se paditësit (kërkuesit) kanë përfitur pension në mënyra dhe mjete në kundërshtim me ligjin, situatë që rregullohej nga paragrafi i dytë i pikës 3 të nenit 62 të ligjit nr. 7703/1993, që përcaktonte detyrimin për kthimin e të gjithë shumës së marrë tepër, duke mbajtur çdo muaj 50% të këstit mujor të përfitimit. Kundër këtij vendimi kërkuesit kanë paraqitur rekurs.

23. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, që do të bënin të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit. Ai kolegji ka vlerësuar se, në raport me pretendimet në rekurs, nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore rezulton se përfundimi i arritur nga gjykata e apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural, ndërsa procesi i zhvilluar ka garantuar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes. Po kështu, sipas atij kolegji, gjykata e apelit ka sqaruar plotësisht rrethanat dhe faktet që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, duke bërë një cilësim të saktë të tyre, përveçse edhe një analizë të hollësishme të dispozitave të ligjit nr. 7703/1993, të cilat rregullojnë mosmarrëveshjen në gjykim. Gjithashtu, ai kolegji ka evidentuar se në rekurs nuk pretendohet se vendimi i gjykatës së apelit bie ndesh me praktikën e konsoliduar të tij apo me vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sikundër nuk është parashtruar ndonjë pretendim për shkelje të rëndë të normave procedurale nga ajo gjykatë.

24. Nën dritën e këtyre rrethanave, Kolegji, duke e vlerësuar çështjen në respektim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe në analizë të vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, çmon se ato u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesve për fitimin e pensionit të pleqërisë dhe se pretendimet e tyre në thelb lidhen me mënyrën se si gjykatat kanë vlerësuar provat dhe kanë zbatuar ligjin nr. 7703/1993 për zgjidhjen e çështjes. Për pretendimin se Gjykata Administrative e Apelit nuk është shprehur në dispozitiv për kërkuesen Bajame Driza, Kolegji fillimisht vëren se nga përmbajtja e rekursit ky pretendim nuk është parashtruar, por është paraqitur vetëm në ankimin kushtetues individual, duke mos shteruar mjetet juridike në këtë drejtim. Megjithatë, Kolegji, nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, konstaton se kjo gjykatë ka arsyetuar në lidhje me padinë e kërkueses, duke argumentuar se ajo ka përfitur në kundërshtim me ligjin pension të dyfishtë, ndaj me të drejtë është urdhëruar mbyllja e atij pensioni që ajo përfitonte pa të drejtë. Në dispozitivin e vendimit, Gjykata Administrative e Apelit është shprehur për pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, duke vendosur shfuqizimin e urdhrin përkatës vetëm për kërkuesin Faik Driza dhe detyrimin e ISSH-së, Tiranë për ta shpallur debitor

për pensionin e përfituar nga DRSSH-ja, Tiranë, ndërkohë që ka rrëzuar padinë për pjesën tjetër. Për rrjedhojë, Kolegji vëren se disponimi i gjykatës për “*rrëzimin e padisë për pjesën tjetër*”, përfshin edhe kërkimet e kërkuases, prandaj dispozitivi i vendimit nuk duket të jetë i paqartë.

25. Gjithashtu, Kolegji vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur për natyrën e shkaqeve të rekursit në vështrim të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, duke vlerësuar se nuk përmbanin asnjë prej shkaqeve të parashikuara në atë dispozitë. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se kolegji në dhomën e këshillimit, kur krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, vendos, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Kjo është edhe përgjigjja që Gjykata e Lartë u jep pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se interpretimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në lidhje me përfundimin e arritur nuk është arbitrar dhe se pretendimi i kërkuasesve për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar. Prandaj, në kushtet kur ndaj tyre nuk ka pasur shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor, edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për pension është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.